



## Katund i Vjetër – Kodër Molung- Kodra Rubik



Sh\_Mr\_003 (Katund i Vjetër – Kodër Molung- Kodra Rubik)



Distance	12.091 m	Starting point	134 m
Duration	4:10	Highest point	605 m
Difficulty	Easy	Finish point	134 m
		Elevation gain	471 m

Emërtim i periudhës romake (Molung-Mons Longus). Ky territor malor i mbuluar me pyje të dendura ku gjenden shumë rrenoja objektesh kishtarë dhe vendbanime të braktisura, është pikërisht vendi ku u farkëtua vetëdija kombëtare e Gjergj Kastriotit. Ndërmjet viteve 1432-1437 ky territor piktoresk u administrua periodikisht nga Gjergj Kastriot Skënderbeu me urdhër të Sulltan Muratit të II-të nga i cili u gradua në pozicionin "Spahi" (Kalorës feudal osman) ku Timari (prona feudale) e cila qeverisej nga Skënderbeu ishte treva e sotme që ndodhet ndërmjet qyteteve Lezhë dhe Rubik. Suksesi i vrullshëm i tij, fama, forca e tij fizike, zgjuarsia, lavdia dhe dashamirësia që ngjallte tek bashkëluftëtarët e tij dhe sidomos tek zemra e



sovrانيت barbar (Sulltan Murati i II-të); u përdorën nga Skënderbeu për ti mbushur mendjen Padishahut (Sulltanit) që t'i jepte të drejtën për të qeverisur një territor sa më afër Principatës së tij atërore, pra sa më pranë Gjon Kastriotit. Kjo dëshirë u realizua pasi Sulltan Murati i II-të e dekretoi si Spahi në territoret lindore të cilat dikur i përkisnin Princit të fuqishëm Arbër, "Dhimitër Jonima" dhe ky Timar përfshinte territorin e sotëm të Malësisë së Lezhës dhe Malësinë e Bulgjerit-Mirditë" ku përveç fshatrave aktualë, atëherë ekzistonin edhe këto vendbanime mesjetare që sot

janë të braktisura , si; Dardha, Tresh i vjetër, Kaprol (Pruell-Spiten), Solamunt (Manati e vjetër), Molung, Gjash, etj. Sundimi mbi këtë territor me rëndësi të veçantë strategjike u kërkuar me ngulm nga vetë Gjergj Kastrioti (Zyrtar osman) sepse kufizohej në jug me Principatën e Gjon Kastriotit, në veri dhe në lindje me Principatën e Dukagjinëve dhe në perëndim, me Lezhën-Veneciane (Civitas Alessio) ku në këtë menyrë ishte në kontakt të vazhdueshëm si me popullsinë vendase, me Babain e tij Gjonin, me Princat Dukagjin dhe me Republikën Veneciane. Në kodrat e Pëdhanës dhe të Molungut, ushtritë osmane u thyen keqas, duke pësuar humbje të ndjeshme në njerëz e materiale luftimi. Dëme serioze pësuan njësitë e pa rregullta. Pas thyerjes së vijës së parë në Molung, «luftime të rrepta u zhvilluan në Rubik (Kryezez), ku qëndresa ka qenë e shkëlqyer, por forcat e mëdha armike dhe mungesa e barutit i detyroi kryengritësit të lëshojnë tokë».

Zona e Rubikut ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në vitet e kryengritjeve për pavarësi. Nga kjo zonë dolën disa figura të rëndësishme të kryengritjeve anti-osmane. Në vitet e kryengritjeve për pavarësi, në Rubik u mbajtën disa kuvende të rëndësishme krahinore dhe mbarë krahinore. Në kuvendin e 1 gushtit 1912, pati përfaqësues nga Mirdita, Kurbini, Bregu i Matës, Zadrima, Lezha, Shkodra, Kruja, Tirana, etj. Me 1 dhjetor të vitit 1912, tek kisha e Shëlbyemit në Rubik, u ngrit flamuri kombëtar.



Fillon nga Restorant Kryezez dhe është i organizuar në formë rrethore. Të ofron përveç natyrës dhe një njohje më të thellë të jetës rurale, në fshat pasi kalon disa herë përmes shtëpive dhe fermave të zonës.



Shtegu përshkon malin e Molungut që fillon në Katundin e Vjetër. Gjatë shtegut gjenden me shumicë bimët e maresë të cilat në vjeshtë të lejojnë të shijosh frutin e tyre, “mollë mret” ose “koçimare”. Frut i cili mblidhet për të prodhuar raki ose për të bërë ëmbëlsira. Mund edhe të hahet, por konsumimi i madh i këtij fruti mund të shkaktojë një “dehje” të lehtë.

Në pjesën më kulmore të malit Molung mund të soditni malin e Velës dhe fshatin me të njëjtin emër. Mund të shihni edhe detin Adriatik. Duhet parë me vëmendje kombinimi i ngjyrave në këtë shteg mes pyjeve, shkurreve mesdhetare dhe gurëve gëlqeror të malit të Velës, detit, qiellit, etj.

*Ky material u prodhua nga Milieukontakt Shqipëri, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij janë përgjegjësi e vetme e Milieukontakt Shqipëri dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe/ose UNOPS-it.*



## Katund i Vjetër – Kodër Molung- Kodra Rubik



Sh\_Mr\_003 (Katund i Vjetër – Kodër Molung- Kodra Rubik)



Distance	12 091 m	Starting point	134 m
Duration	4:10	Highest point	605 m
Difficulty	Easy	Finish point	134 m
		Elevation gain	471 m

This period is referred to as "Molung-Mons Longus" in the text. It encompasses mountainous territories covered with dense forests, where many ruins of church objects and abandoned settlements are found. This is considered the place where the national consciousness of Gjergj Kastrioti emerged.

Between the years 1432-1437, Skanderbeg periodically administered this picturesque territory by order of Sultan Murad II. During this time, Skanderbeg graduated to the position of Spahi (Ottoman feudal cavalryman), and the timar (feudal property) governed by Skanderbeg was the present-day land between the cities of Lezhë and Rubik.



His success, fame, physical strength, intelligence, glory, and the love that he inspired in his comrades, especially in the heart of Sultan Murad II, were used by Iskender-Beg (Skanderbeg) to persuade the Sultan to grant him the right to govern a territory as close as possible to his own principality, i.e., as close as possible to Gjon Kastrioti.

This desire was fulfilled after Sultan Murad II decreed him a Spahi in the eastern territories that once belonged to the powerful Prince of the Albanians, "Dhimiter Jonima." This Timar included the territory of present-day "Malesia e Lezhës and Malesia e Bulqizës-Mirditë," where, in addition to the current villages, there were medieval settlements that are now abandoned, such as Dardha, Tresh i vjetër, Kaprol (Pruell-Spiten), Solamunt (Manati e vjetër), Molung, Gjash, etc. The control over this territory, with particular strategic importance, was strongly sought by GJERGJ KASTRIOTI (an Ottoman official) himself because it bordered to the south with the Principality of Gjon-Kastrioti, to the north and east with the Principality of Dukagjini, and to the west with Lezha-Venetian (Civitas Alessio). This way, he was in constant contact with the local population, his father Gjon, the Dukagjini Princes, and the Venetian Republic.

In the hills of Pëdhanë and Molung, the Ottoman armies suffered severe defeats, experiencing significant losses in both personnel and military equipment. Serious damage was inflicted on the irregular units. After the first line was broken in Molung, "fierce battles took place in Rubik (Kryezez), where the resistance was excellent, but the large enemy forces and the lack of gunpowder forced the insurgents to abandon the land.



The Rubik area made a significant contribution during the years of uprisings for independence. Several important figures in the anti-Ottoman uprisings emerged from this region. In the years of uprisings for independence, several crucial regional and overall regional assemblies were held in Rubik. In the assembly on August 1, 1912, there were representatives from Mirdita, Kurbini, the Mat region, Zadrima, Lezha, Shkodra, Kruja, Tirana, etc. On December 1, 1912, at the Church of Shëlbuemi in Rubik, the national flag was raised.



It starts at the Kryezez Restaurant and is organized in a circular form. Besides nature, it offers a deeper understanding of rural life as it passes several times through the houses and farms of the area.

The trail traverses the Molung mountain, starting from the Old Village. Along the trail, you'll find an abundance of wild apple trees, which in the fall allow you to taste their fruit, known as "mollë mret" or "kocimare." This fruit is harvested to produce raki or make sweets. It can also be eaten, but excessive consumption may make you feel a little bit dizzy.

At the highest point of Mount Molung, you can admire the Velë mountain and the village of the same name. You'll also have a view of the Adriatic Sea. Pay close attention to the combination of colors on this path amidst the Mediterranean vegetation, the rocks of Velë mountain, the sea, and the sky, etc.

*This material was produced by Milieukontakt Albania, with the financial support of the European Union. Its contents are the sole responsibility of Milieukontakt Albania and do not necessarily reflect the views of the European Union and/or UNOPS.*